

SHPALLJE PËR:
LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË: EKZEKUTIVE

Lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike/Juridike/Inxhinierike", niveli minimal i diplomës "Master Profesional"

Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe të kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- **Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale- kategoria: IV-a (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist (për Prokurimet) në Sektorin e Shërbimeve dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme- kategoria: III-b (Shkenca Juridike)**
- **Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Administratën e Prefektit të Qarkut Vlorë - kategoria: IV-b (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike)**
- **Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Kulturës - kategoria: IV-a (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Kulturës - kategoria: III-b (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria: IV-a (Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Drejtorinë e Prokurimeve, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive - kategoria: IV-a (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Drejtorinë e Prokurimeve, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive - kategoria: IV-a (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Drejtorinë e Prokurimeve, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive - kategoria: IV-a (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Drejtorinë e Prokurimeve, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive - kategoria: IV-a (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**

- **Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - kategoria: III-b (Shkenca Ekonomike /Shkenca Juridike /Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural- kategoria: III-b (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike)**
- **Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit- kategoria: III-b (Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike)**
- **Specialist (për Prokurimet Publike) në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit - kategoria: IV-a (Shkenca Juridike)**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE	26/11/2022
Afati për dorëzimin e dokumentave për: PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL	1/12/2022

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

- Harton thirrjet për tenderat për prokurimet publike dhe organizon procesin e marrjes së ofertave;
- Përgjigjet për marrëdhëniet kontraktuale me furnitorët dhe kontrollin e përmbushjes efektive të kushteve të kontratës nga ana e furnitorëve;
- Në bashkëpunim me njësitë e tjera harton kushtet kryesore teknike të thirrjes së tenderave;
- Organizon procesin e shqyrtimit dhe analizimit të ofertave;
- Harton kriteret ligjore të kontratës përfundimtare;
- Komunikon me fituesin e tenderit dhe monitoron realizimin e kontratës;
- Përgatit regjistrin e parashikimit të prokurimeve, konform buxhetit të miratuar për investime dhe për shpenzime;
- Harton urdhrat e krijimit të komisioneve të ndryshme të prokurimit dhe njoftimet përkatëse për APP-në për çdo objekt prokurues;
- Kryen veprimet në sistemin e APP-së për shpalljen, kalimin e njoftimeve, arkivimin e procedurave apo mbylljen e fazave të vlerësimit;
- Përgjegjës për dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore në fushën e prokurimit publik, me qëllim zbatimin me saktësi të dispozitave ligjore në fuqi;
- Përgjegjës për kryerjen në kohë dhe me cilësi të inspektimit të dosjeve dhe raportimin për monitorimin e procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkenca Ekonomike/Juridike/Inxhinierike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër:

1- Do të bëhet online, në faqen zyrtare elektronike të Departamentit të Administratës Publike, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijimësi udhëzimet online në linkun më poshtë:

<http://rekrutimi.administrata.al/autentifikimi/regjistrim>

2- Në përfundim të aplikimit online, dokumentat e përmendura më sipër, së bashku me një kërkesë ku ju specifikoni pozicionin ku dëshironi të konkuroni, duhet të dorëzohen pranë institucionit që ka pozicionin vakant për të cilin ju aplikoni. **1/12/2022**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28/11/2022**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të DAP, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të DAP, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Departamentit të Administratës Publike, duke filluar nga data 14/12/2022

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkenca Ekonomike/Juridike/Inxhinierike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b - Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen zyrtare elektronike të Departamentit të Administratës Publike, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijmësi udhëzimet online

<http://rekrutimi.administrata.al/autentifikimi/regjistrim>

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës:

1/12/2022

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14/12/2022**, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga DAP, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerëimit të kandidatëve, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Departamentit të Administratës Publike, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Departamentit të Administratës Publike duke filluar nga data 14/12/2022